

PANO
ÇUKA

Udhëroni
në vendlindjen
time

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-1

E 92




vjersha e poeme

PANO ÇUKA

URDHËRONI
NE
VENDLINDJEN
TIME...

Vjersha e poemë



SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

SKËNDERBEU

Nga shekujt na fanitesh, Skënderbe,
mbi atin këmbëshpejtë e luftethinjur,
me shpatën tënde madhështore çveshur;
ish tringëllima e saj-kuj' e armiqve,
shkëlqimi i saj — shkëlqimi i fitores.

Dhe ati hingëllin siç hingëllinte
dhe atëhere kur i shpoje brinjët
që të lëshohej nër betejat flakë,
kufomat duke shkelur që i ngjanin
atkosit korrur fushës nga ajo shpatë
që i ka hije burrit;

se mëshira
kundrejt armikut, dobësinë ka motër.

Gjokset-lëmenj të trimave të tu —
shtrënguar pran' e pranë, që të ndjejnë

rrahjet tokmak të zemrës së shojskokut,
ngritën bedenat e një lloj kështjelle
që s'ishte parë dhe kishte si kurorë
gjoksin tënd leshtor dhe erërrahur.

Asqerët e armiqve atje shëmbeshin,
siç shëmben valët mbi shkëmbenjt e bregut;
thyheshin, ulërinin të përgjakur,
suleshin prapë e thyheshin sërish.
Edhe gjakosja e tyre ish çdo herë
më e rëndë e më i thellë turpi i tyre.
E sa më poshtë merrnin rrokullimën
ato hordhi, me turp, nëpër humnera,
aqë më lart lavdia jote ngjitej
në eterin që s'i gjendet fund e anë.

Pa po u bë ajo legjendë e këngë,
ninull' e ëmbël e foshnjave në djep,
kushtrim i zjarrtë, një trumbetë zgjimi
që gjuhësh të panumërta jehonte,
se ti i kishe këmbët të rrënjosura
në tokën amëtare, kurse shpata,
që vringëllinte në mejdan të luftës,
kryet e osmanllive duke korrur,
priste dhe lakun që për aqë popuj
gati e kish bërë vdekja e pabesë.

Me frymëmarrjen e shqiptarve, Skënderbe,
dhe ata popuj merrnin frymë!
Mbi gjoksin burrëror të shqiptarit
— kështjellë e pamposhtur e lirisë —
u mek vërshim i trubullt i errësisë.

Në ata gjokse gjete ti lirinë,
në ata gjokse gjete ti thëngjillin
dhe flakën ndeze zjarr të trimërisë;
në ata gjokse gjete ti besimin,
që kush e ka nuk jepet asnjëherë:
«Në qoftë, the, se unë s'do jem më
populli është i madh e nuk vdes kurrë.
Cilindo past armik s'do ta pushojë
luftën por me hov të ri do të fitojë!»

Me atin tënd, që ngrihet sipër dheut,
shekujt do shoqërosh, o Skënderbe.
Lavdia fluturon pas teje dhe mban
plloskën me verën gjak të heroizmit,
qeras me të çdo brez e plloska prapë
qëndron e mbushur plot me verën tënde!

DUEL ME VDEKJEN

Shqiptari e ban dekën si me le.

Populli

Mesnatë...

Fashistët si rrebesh
u derdhën në gelinë e myshkët.
Ai — një i vetëm, buzëqesh.
Ata — një turmë, vështrojnë me frikë.

Ecën...

Ai bën të fundmet çape
dhe shkel i sigurt e krenar.
Ata do kthehen të gjallë prapë,
por dridhen sikur venë në varr.

Shulet e pushkëve zhurmuan,
vrapuan fishekët në foletë.

Ata — lëvizën të shqetësuar.
Ai — qëndron përballë i qetë.

Befas, një zë në errësirë
jehoi si një krismë e thatë:
— Thua, a ke ndonjë dëshirë
para se të të përpijë kjo natë?

— Po — u tha trimi.

Dhe xhelatët
i mbajtën veshët si qen gjuetie.
«Mos vallë e trembi varri i hapët?
Mos vallë në gjunjë do të bie?»

— Dua — vazhdoi ai — një krehër
të kreh pak flokët që m'u prishën;
si në ditë feste, porsi dhendër
drejt vdekjes sot dua të nisem.

Gjëmuan pushkët. . .

Por më shumë
gjëmuan ato të pakta fjalë.

Erdhën e u frynë si një furtunë
e tundën fushë e tundën malë.

Armiqtë, të zverdhur, ulën kryet.
Nata u bë sterrë, mbytëse, e ftohtë.
Tërë dritën trimit ja dhanë yjet,
era vrapoi t'i krihte flokët...

VARGJE PËR HEROIN

Thodhori Mastorës

Me flokë të shpupuritur kur sulej në beteja,
— i pari porsi shkrepëtimë që lajmëron furtunën —
thua sikur hakmarrja vetë shtatin e tij po mirrte
e shqipet trimin komunist me admirim vështronin.
Dhe kur betejet mirrnin fund e batalioni çlodhej,
si shatërvan të qeshurat i derdhte komandanti.
Qafuhej me shokët ngrohtësisht dhe dridhte me ta
vallen.

Kur fliste, sikur ndjente pranë hapin e vetë fitores.
Dhe kur në ballë një plumb armik e gjeti dhe e rrëzoi,
i hapi duart si dy flatra të përfaqonte tokën.
Gjaku i dliurë si trëndafilë u hap nëpër dëborë.
S'kish lule më të bukura lirinë të përshëndeste.

BALLADË PËR NJË TUFË FLOKËSH

*Kur të vizitoni muzeun e Gjir
rokastrës vëreni me kujdes një
tufë flokësh të heroinës Perse-
foni Kokdhima...*

Një tufë flokësh sollën një ditë në muze.
Dhe na flasin flokët; (ç'ne se s'kanë zë?)

Vetëm dorë e nënës i kish përkëdhelë
ata flokë të butë, në shami mbështjellë.

Dhe vetëm Liria, atje lart në mal,
i pat shpupuritur flokët me ngadalë.

Kurrë ndonjë furqetë me gurë të çmuar
ata flokë të artë s'i kish zbukuruar.

Veçse dimrit të egër flokëbardha borë
thurte shpesh mbi to, ditë e natë, kurorë.

O, sa bukur vinte mbi ata flokë të butë,
kapa partizane me yllin e kuq.

O, sa bukur flokët hapeshin në erë,
si krahë dallandyshe në një parëverë.

O, sa bukur flokët do hapeshin sërish
ditën e Fitores, në vallen e Lirisë.

Ata flokë të butë thellë në një qeli
u lëshua t'i shkulte një armik i zi.

U lëshua t'i shulte ata flokë të artë,
se nuk gjunjézonte një zemër të zjarrtë.

Disa fije flokësh që ranë në qeli,
sikur u bënë tela për një çifteli.

Dhe i ra Lavdia asaj çiftelie
dhe shpërndau këngë, zjarr trimërie!

MALET SHQIPËTARE

Të madhërishëm, ballëlartë, thellë e më thellë stisur
e lartësojnë në hapësirë malet shqipëtare shtatin.
Dhe siç sodit një fitimtar larg fushën e betejës,
ashtu dhe malet krenarisht të shkuarën sodisin.
Dhe siç sheh udhën para tij një fluturak vraponjës,
që di për ku ka marrë vrap, ato sodisin t'ardhmen.

Dhe këto male ishin dikur lëmënjtë e mermertë
ku Shqipëria fytafyt me robërinë ndeshej.
Edhe në çdo përleshje, edhe në çdo betejë
shtat më të madh lëshonte lart lavdia shqipëtare.

Edhe kur robëria u mund dhe zonjë u bë jeta,
malet shfletuan qetësisht kujtimet e kaluara
që brezave të ardhme se ç'panë t'u rrëfejnë.
Pranverave të vishen nur me gjelbërim e lule,
dimrit të hedhin supeve kapotën e bardhë borë,

t'i rrahin tramundanat fort, t'i përkëdhelin flladet,
te ujëvara e shirave trupin ato të lajnë,
të pinë frymëmarrjen e bredhit e të qitrës,
në fluturim t'i shohin lart shoqet e tyre, shqipet,
tinguj këmborësh të dëgjojnë e blegërima qingjash;
dhe nëpër këtë simfoni të moçme, të dëgjojnë
notat e reja që shpërndan çekani i gjeologut;
silahun e taracave të kaltër' ato të ngjeshin.

Pa të sodisin fushat pa anë e fund, me lule
që zhytur thellë në atë det të grurit shëmbëllejnë
dhe kadifenë e misërit, të blertë, kanë veshur
edhe sheqer panxhareve nga trupi i tyre u japin.

E të vështrojnë pemët tej që varin nëpër dega
kokrra ullinjsh si rruaza plot me shkëlqim, pa numër,
edhe të portokaleve vëthët e tyre t'arta,
mollët si faqe nuseje ndënë një tyl të blertë.

Buçitjen e traktorëve të ndjejnë dhe lumenjtë
të shohin kur u vënë fre njerëzit llërëfortë,
e t'u gëzohen shtyllave të larta që po mbijnë
si goxha pemë të hekurta, në pyje e shkretëtira,
mu si gjigandë që kudo dritë edhe shkëlqim
përhapin,
dhe duken si trekëmbështa ku varet errësira.

Ja se si duan malet, që s'kanë mort, të rrojnë.
Malet shqipëtare janë të urta dhe krenare;
po n'i mbërtheftë ndonjë çast armiqtë çmënduria
e shtrifshin dorën maleve, ato do të ulërijnë,
siç nuk do të ulërinin dot dragojtë e gjithë
përrallave;
si partizanët do qëndrojnë dhe me gjerdanët
ngjeshur
që sot s'mbajnë më fishekë, por vetëtima mbajnë.

NË FUSHËN E HELMËSIT

*Shoqeve dhe shokëve delegatë
në kongresin I të BRASH-it*

Një fushë më shtrihet përpara shpesh herë,
një fushë mbi një mal;
rri nën hijen e lisave të moçëm, të blertë,
shuaj etjen në ujët
që rrjedh nga një gurrë, si kristal.

E mblidhen në fushë plot shoqe dhe shokë
dhe unë midis tyre humbas.
Me radhë, porsì vëllezër të zemrës i rrok,
gjuhën gazi ma lidh,
dhe me sy e buzëqeshje u flas.

Nga fushat e luftës, në këtë fushë
i dërgoi Shqipëria një gusht të nxehtë
të mendonin,

se si rinia do ngrinte më lart atë grusht
dhe «malin që s'bëzante», ta shëmbte përjetë.

Ata qenë të rinj, dhe qenë më të fortë
se lisat që fushën rrethonin.

Mbi supat e tyre mbështetej një botë,
«si një godinë përmbi shtylla betoni».

Terri i skamjes u errësonte sytë,
asnjë gëzim s'u kishte hapur zemrat:
por Partia nënë,
sytë ua bëri diej një ditë
dhe zemrat-gurrë,
nga buronin më të pastrat ëndrra.

Këtu do të mblidhemi shoqe dhe shokë,
shpesh, porsì vëllezërit, që janë të shpërndarë,
e vinë në dasmat e festat gjithë tok
në strehën e ngrohtë familjare.


Me ne do të vinë siç qenë të rinj,
dhe shokët që ranë si trimat në këmbë.
Në valle do dredhin të parët shaminë,
të parët do t'ja marrin një kënge.

Dhe zëri i tyre porsi bubullimë
në fushë do dëgjohet krenar:

«Shokë!

Ne ramë për lirinë, ju mbroni lirinë;
në llogore me ju do qëndrojmë ushtarë».

Eh, ju kujtime të dlira nga ditët,
që ecnin mes flakësh me vezme në brez.
Ju jeni si vera e vjetër, që sa kalojnë vitet,
më tepër na deh dhe etjen na ndez.



DUARVE TË PUNËTORËVE

Duar të punëtorëve, të ashpra, të plasaritura,
ngrohni në grushtet tuaja ëndrrat më të ndritura.

Damarët tuaj si binarë të nderrë mua më ngjasin.
Mbi to trenat e lumturisë ngarkuar rëndë rrëshqasin.

Kur rrokni veglat sikur ju bëni me të ardhmen toka.
Dhe atje uzinat marrin shtat dhe pjellshmëri merr
toka.

Jini të ashpëra si një shkëmb, të forta si çekani,
por kur shpërndani
të dashurve, fëmijëve, përkëdheli, pekule,
bëhi të buta sa nuk është asnjë gëzof o lule.

Kur rrokni duart e shokëve, pëllëmbët ngjajnë me
vatër
ku ndizet zjarri më i kuq i dashurisë së pastër.

Por kur armiqtë godisni, fort kockat e tyre krisin,
se ju, duar, që druheni një bisk të njomë të prisni,

i prisni armiqtë si degë të thatë me një të shenjtë
urrejtje;
(sepse po nuk urrejte armiqtë nuk dashuron as jetën!)

Ju, duar të punëtorëve, të ashpëra, të plasaritura,
ngrohni në grushtet tuaja ëndërrat më të ndritura.

SHKOLLË REVOLUCIONI

Të rralla i kishte shkollat Shqipëria
— oaze në Saharën e padijes. —
Etja ishte e madhe, të eturit me mijra.
Në atë torbë të thjeshtë, të endur me lesh dhie
që hidhte supeve, kur nisej në luftime,
bashkë me pak bukë të thatë, misërishte,
e me ca plumba,
 ndonjë libër kishte,
që e hapte shpejt në të shkurtërat pushime. . .

Dhe ja, një shkollë u bë tërë Shqipëria,
ku dhe miliona shokë mësimë mund të marrin,
më shpejt arën e jetës të tëharin,
si grurë i mbarë të piqet lumturia.

SYTË E TË VERBËRIT

Ilia Gazhgës

E çdo të thotë në je i verbër?
Kurrë s'e humbet dritën e artë
ai që mu si pishë në zemër
i ndrin një ide e madhe e zjarhtë!

Dhe në se nata t'i ka kyçë
qepallat si kanatë-sterrë,
ti optimizëm ke tepricë,
të ushqesh me të edhe të tjerë.

Violina jote — çerdhe e ngrohtë
nga merr gëzimi fluturim;
violina jote — varr i ftohtë
i dëshpërimit, shoku im.

Kordat e saj — tela tensioni,
përçuesa drite, endrrash, shpresash,
fitile me zjarr revolucioni,
që ndez tritolin nën pengesa.

Çdo tel, porsi kanal, që jetë
u jep të mbjellave në fushë,
vadit në zemër të vërtetën
dhe me blerim besimi i mbush.

Ndonjerit, po t'i mirren këmbët.
shpirtin të dobët po ta ndjejë.
në sytë e tu, si në një çezmë.
forcë të pashtershme do gjejë.

Ti sheh uzina, shkolla, brazda,
sheh bukuritë e Shqipërisë,
o komunist Ilia Gazhga,
me sytë e ndritshëm të Partisë!

MOTIV KURBETI

Atje ku rrjedh një gurrë e ftohtë.
në anë të fshatit, nën një arrë,
sytë, porsi kroje, derdhnin lotë,
shkriheshin zemrat në të qarë.

Djemve u flisnin me ngadalë
mes vajit nënat shamizeza:
«Ktheu nga mërgimi shpejt, mor djalë,
të mos më gjesh posht në varrezat».

Nuset atje i kthenin zemrat
në arkivol të akullt, të zi,
dhe kyçnin thellë gëzimet, endrrat,
kyçnin të vyshkurën rini.

PORTRETE DIELLI

I zyrtë ngrihej dielli mbi Vurgun e ngratë
dikur, në ato t'errëta vite.

Rrallë, nga të çarat, në kasollet me baltë
hidhte mëshirshëm disa fasha drite.

Zhytej e ndotej në moçale përditë;
nga një tym i hidhur lotonte.
Kurrë s'u kish parë njerëzve sytë;
vetëm kurrizin e kërrusur u shikonte.

Po kurrë më s'do zgjohet i zyrtë, i trishtuar.
S'do të ndotet në llumë;

ku genë moçallet
praron pemë e të mbjella dhe ecën kaluar
mbi shpinë të ujit që shket nër kanalet.

Në sytë e njerëzve, si në pasqyrë,
veten shikon dielli kudo që vete.
Hyn nër shtëpitë si një mik i mirë,
dhe shpesh në dritare var autoportrete

KËNGËVE POPULLORE

O këngë ritmëzgjatura, o këngë ritmëshpejta,
këngë trimërie mbushur zjarr, krahëlehta këngë lirie,
këngë që tërmeti i dashurisë ju lindi nëpër zemrat,
këngë-psherëtimë e një violine, këngë-murmuritje
kroi,

magji e mendjes jeni ju dhe dehj' e zemrës jeni,
këngë, që derdheni rrëke nga telat e lahutës
kur i pari i poetëve, popull' i madh, i bie.
Ju, këngë, ngjani si pasqyrë e pastër, e kristaltë,
ku po shkëlqen me madhështi shpirt' i krijuesit tuaj,
i dlirtë, i gjerë si oqean pa fund edhe pa anë,
me gjithë tallazet dhe me tërë qetinë e tij të ëmbël.

NUSE DROPULLITE

1

Ushtojnë sazet papushim, hej, hej, dhe meloditë
valë-valë derdhen lehtë.

Në mes të avllisë, nën pjergullën, të rejat dhe të rinjtë
vallzojnë këmbëshpejtë.

Marrohet sot një vashëzo me buzët si ngjyrëkorali,
flokëverdhë, truplastar;
të bardhë e ka shaminë në kokë, posi dëborë mali,
futën qindisur ar.

Shoqet, si bletë, me dashuri nusen e re rrethojnë
— o, ç'ëndrra endin dhe ato —
dhe këngë të dasmës, të haresë, të bukurisë jehojnë
gëzueshëm kudo:

«Stoliset sot kjo nusja jonë dhe vë fytyrë të saj
diellin që shkëlqen;
na i ka sytë pors i filxhan, vetullat si fiskajë
dhe ballin pors i hënë. . .»

Pas pak një tjetër këngë jehon dhe sjellë aromë fushe,
pëllitje viçash sjellë:
«Të ndrisin sytë dhe bluza e bardhë të ndrit përditë,
moj nuse,
në stallë, kur lopët mjel. . .»

2

Nusja, mes shoqesh, buzëqesh fshehtas dhe mendja
prore
i breddh krahëlehtë larg;
shoqëron dhëndërin që po vjen me saze, me dasmorë
dhe me dasmorë — një varg..

Dhe i kujtohet dridhja e parë e zemrës — o ç'kujtime
që ndezin shpirtin zjarr! —
ankthet, pikëpyetjet, druajtjet, buzëqeshjet, ëndë-
rrimet
dhe ai takim i parë.

Dhe i kujtohet gjyshja e mirë që vetëm atë natë
nuk e vështroi ndër sy;

veç me një zë, si psherëtimë, e pyeti plaka e ngratë:
«Kaq vonë, moj bijë, ti?»

Dhe i kuitohet tezja Anë që në qytet për «mbesën»
një «fat» gjeti me ngut.
Sa e donte tezen. . . po sa shumë e ka urryer shkesën,
sa e huaj që iu duk. . .

3

Dhe ja dasmorët iu afruan shtëpisë avash-avash,
kënga plot gas jehon:
«I ndrituri ylli që po shkon pranë shënjzës, o vashë.
rrugën për tek oborri yt sot mua më tregon»...

4

Në krye të shkallëve qëndron e vjehra me një ndjenjë
hareje e mallëngjim
dhe mbush me puthje vashëzën e saj të re, si nënë,
dhe djalin e saj trim.

E kthejnë vallen rrotull-o të rejat dhe të rinjtë,
dikush shaminë po tund;
violitë përhapin pa pushim valë-valë meloditë
dhe s'kanë urimet fund. . .

KONIZMAT

Fytyra të ngurta të perëndive e shenjtorëve,
hie e një nate t'egër, të thellë.

Kurrë s'egzistuat, por u ngjanit xhelatëve:
vrisnit viktima e mbronit kriminelë.

Rojë i qëndronit arit e pallateve,
që thika e vjedhja i ngrinte gjer në retë.
Zotërive u fshihnit llumin e mëkateve
dhe në llum shtinit njerëzit e thjeshtë.

Në mendjet derdhnit serën e kazaneve
që kurrë s'kanë vluar (s'ishin veçse përrallë).
Dhe shkrinit forcën, zemrën e të varfërve,
që zotërinjtë t'i digjnin qetë, të gjallë.

Tani ju hodhëm ne në mes të flakëve
e fshijmë nga shpirti blozën që na latë.
Dhe vetëm duke u djegur, o thikë të xhelatëve,
për herë të parë një ndriçim shpërndatë.

URDHËRONI NË VENDLINDJEN TIME

poemë

1

Në viset ku të parën klithmë
një mbrëmje maji nxora unë,
ku vitet e rinisë më iknë
gëzime — pak e brenga — shumë;

në këto vise, që në zemër
më ndezin zjarre nostalgjie,
urdhëroni një vizitë, vëllezër,
t'ju prij në prak si miq shtëpie.

2

Do të kalojmë ndër zabele,
në kodra e pllaja zaje — plot,

që njerëzit zbathur i kanë shkelë
dhe i kanë njomë me gjak e lot.

Por si këmbësorë të dërmuar
s'do të udhëtojmë kurrë më,
sepse «koria» ka shkurtuar
distancë e lodhje përgjithënjë.

Dhe nga dritaret tërë vendi
si në një film të shpejtë kalon.
Ja: pyje lisash hijerëndë,
përposh një lumë gjarpëron.

E këtë rrugë në të përpjeta,
në shpella, grykë e greminë,
nuk e shënuan, shokë, piketa,
por pika gjaku si rubinë.

Të tilla shënja, që asnjëherë
kohrat s'i shuajnë nga kjo tokë,
ka shkelur jeta e si pranverë
erdhi në këto male, shokë.

Dhe ndërsa ne do të kalojmë
përmbi «korierën» tonë krenarë,
nga majat do të na ngjatjetojnë
me mijra trima luftëtarë.

Hej, dhe këto malet e mia,
që qiejt për kurorë u rrinë,
limer i kishte Trimeria,
vetëm një Zanë kishin-Lirinë.

Këtu dhe gurët në çdo anë,
kodrat, lumenjtë e bokërimat,
flasin për djemtë si luanë,
flasin për vajza gjeraqina.

Akoma duket sikur flakë
lëshojnë pushkët e granadat,
kur hodhë barinj të në batakë
akademi, shtabe e grada.

Një zë akoma po merr dhenë:
«Jam Vetëtima, më dëgjon?»

Ai s'ish zë — tritol ka qenë
që plaste mes armiqsh gjithmonë.

4

Në fshat fshatarët mirëseardhjen
do na urojnë ngrohtësisht,
do na shtrëngojnë duart me radhë
e do na puthin shqiptarisht.

Dhe kur ngadalë në mugëtirë
do të pështillet fshati im,
të gjithë fshatarët, mysafirë
do na kërkojnë me gëzim.

5

Si lisat, që rrënjosur janë,
bashkëvendasit e mi qëndruan.
Gjokset i vunë pranë e pranë,
dhe një beden të fort formuan.

Turma e armiqve priste e grinte,
vraponte zjarri flokëlëshuar,

dimri-lubi na ulërinte,
kafshonte uria e tërbuar.

Vdekja e pabesë kishte pritë
në çdo udhëkryq e monopati,
porse bedenat s'u rrëzuan,
nuk ranë lisat shtatëlartë.

6

Dhe nëse nga sopata e mprehtë
e vdekjes disa trima ranë,
me jetë të re tani përjetë
po rrojnë me të gjallët pranë.

Dhe mbajnë parmëndën e traktorin
kur bijtë arat sot lërojnë;
kur flokt' e verdhë të tokës korrin
edhe ata drapërin shtrëngojnë.

7

...E do na thonë për maja e pllaja,
gjokset e maleve krenarë,

ku binte pushka e kumbaraaja,
ku fyelli tretej duke qarë.

Tani, do të thonë, se me dhënarët
rrinë shpesh, nën çadra, këmbëkryq
heronj romanesh dhe shkrimtarë
e shtruar bisedojnë si miq.

E do na thonë për kopshte e ara
anës lumenjve, mbi shkëmbinjtë,
ku ulin, mbi kallama të arta,
kryet mendueshëm, kalinjtë.

Për mbi pejsazhe, shokë, të vjetra
ngjyra të reja do dëftojnë:
ngjat lisave — shtylla shtatëdrejta,
mbi mal — traktorë që lërojnë.

8

Në atë bisedë të ngrohtë, të gjatë,
me siguri plot adhurim

fjala do kthehet shpesh te gratë,
të thjeshtat gra të fshatit tim.

YARGJE PËR GRATË E FSHATIT TIM

I kam fshataret shumë të zonja,
këtë për mburrje nuk jua them.
Me shpejtësi ere punojnë
në arë, në mal, në vreshtë, në lemë.

Të mira janë sa nuk bëhet,
s'gjen dhëmshuri si tek ato.
Por kur i ze zemërim i shënjtë,
meduzë tjetër mos kërko,

(Porsi meduza ca fshatare,
me ca sopata e ca vrialë
u derdhën mbi nja dhjetë xhandarë
që ikën si qen me bisht ndër shalë).

Nuk them se janë «shtojzovalle»,
kanë një të thjeshtë bukuri.
Por zemër si të tyre rrallë

do gjesh me aqë pasuri.

Gruaja e shkretë!... Ç'hoqi shumë!...

E vriste burri me një zë:

«Moj, komandar këtu jam unë

dhe ti një skllavja ime je!»

Dhe në përbuzje ngryste ditët
fshatarja ime buzëçarë,
gjersa Partia solli vitet
që i dhanë nga zjarri i tyre zjarr.

Dhe në ato kohëra tufanesh,
ato, të vuajturat fshatare,
u bënë nëna partizanësh
dhe motra bashkëluftëtare.

Në duart e reshkura, të thata,
sikur u mirrnin krahë shtizat,
kur thurnin, netëve të gjata,
të dritë e zjarrit me ca driza,

fanella e çorape të ngrohta
për djemtë që maleve u ngjitën,
vrisnin armiq e mundnin shqota
edhe po hapnin rrugë për dritën.

Në ato shtëpiza varfanjake
krahëhapur djemtë e tyre i prisnin;
siç kishin plot me zjarr oxhakun,
plot dashuri zemrën e kishin.

Shpesh, kur sulmonin batalionet,
të fortat gra të fshatit tënë,
mbartnin, pa bukë, municione,
armët mos mbeteshin pa ngrënë.

Gruaja e mirë !...

Në dhenë e murmë
sa gjurma gjaku la ato vite...
Por çdo pikë gjaku e çdo gjurmë
u bënë gurra gazi e drite...

Turp më s'i vjen t'i ngrëjë sytë,
vështrimin para drejt të kredhë.
Me shpatë qëllon padrejtësitë
dhe mbi çdo myk rrufenë hedh.

S'është më «thëllëza» e këngës së lashtë
që «e rrëmben dhëndri si skyfter».
Sulet në luftë me dhëndrin bashkë
dhe mbyt çka mbyste jetë e nder!

Kurrë më krushqarët s'do t'ja shesin
zemrën si plaçkë në pazar.
Ajo si krimb shkel interesin
dhe vetëm zemrën vë krushqar!...

9

E do na thonë... ç'nuk do na thonë...
(Eh, nuk i them të gjitha dot!)
Fshatarët tanë kur bisedojnë,
të dehin si me verë të fortë.

Thua se ardhmja, lumturia,
me zënë e tyre do të na flasë,
dhe Enveri, nga fotografia,
do na vështrojë me buzë në gaz.

10

Por, mos pandehni se mbi lule
shkel jeta në vendlindjen time,

vetëm me këngë e me pekule,
e qetë, pa erëra, pa gulçime.

Atje fshatarët do të na flasin
edhe për erëra dhe tallaze.
Ka, do na thonë, ndonjë që lafshën
tund si kaposh nëpër pullaze.

Ndonjeri vetullngrysur, grushtin
mund të lëshojë dhe mbi tryezë;
veç, iku tashmë vapa me gushtin,
fshati mbi shpinë s'mban më këndeze.

Ka dhe ndonjë që sytë e veshët
i hap vetëm për të tjerët
dhe mbjell, si krisje, pëshepëshet
në ndonjë krua a ndonjë derë.

Ka dhe ndonjë që lëshon flakën
mbi ca që «s'respektojnë» gratë.
por, po s'e gjeti gati darkën
e kthen moralin në shamatë.

Ka dhe ndonjë që dënon huqet,
por punës vetë i bën bisht,

edhe ndonjë që ndër sënduqet
mban fshehurazi të drunjtin Krisht. . .

11

Për darkë do shtrojnë në tavolinë
gjellë të gatuar me sevda,
bukë, si sfungjer, që gjithë mjeshtërinë
i ve ai furxhiu usta.

Dhe ora e gjumit kur të vijë
krevat të butë do na shtrojnë,
çarçafët do të vetëtijnë
dhe erë sapuni do kundërmojnë.

12

Dhe kur të agojë dita flokëartë
do të ngarkojnë kafshët shpejt,
e ca do ngjiten malit lartë,
e ca në vreshta do venë drejt.

Të shkojmë dhe ne me ata bashkë?
Veçse dëgjoni (s'është sekret!)

Punën e kanë si masë të saktë,
që masin njerëzit në jetë.

Prandaj parmëndën fort shtrëngoni,
shkoni me dhentë me shark mbi supe,
mburrje të drejta të fitoni
dhe dashurinë e ndonjë çupe!

13

Dhe sikur natën, në errësirë,
në zheg të vapës, në acar,
armiqtë të na kafshojnë kufirin,
fshatarët, si të jenë ushtarë,

do rendin me armë në dorë,
t'ua bëjnë korbave ushqim.
Po pse jua them? Nërpër llogore
do jemi bashkë mbi fshatin tim.

14

Si thatë? Do më kritikoni
se janë si shumë këto që them?

Mundet, por, ama, mos harroni
se nesër pak ato do jenë.

Kështu për vendlindjen tuaj
dhe ju krenohi, sigurisht,
e s'druheni se do t'ju quaj
ndonjë i rrëmbyeshëm, «lokalistë».

Mos, vallë, çdo fshat e çdo krahinë
nuk është një e gjelbërt vllanjë
në vendin tonë, në Shqipëri,
që me një bahçe lulesh ngjan?

15

Urdhëroni në vendlindjen time
dhe kjo vizitë e shpejtë, patjetër.
ndër më të bukurat kujtime
do jetë për ju, të dashur vëllezër!